

VENDIM
Nr.497, datë 29.6.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
TE MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, TË MJEDISEVE DHE SIPËRFAQES 2716 M², NGA
TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.98, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK
NR.5011”, BRAR, TIRANË, TË MJEDISEVE DHE TË SIPËRFAQES 12150 M², NGA
TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.109, ME EMËRTIM “RIPARIM ARTILERIE”
SHA, BRAR, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË
18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të mjediseve dhe sipërfaqes 2716 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr.98, me emërtim “Reparti ushtarak nr.5011” Brar, Tiranë, të mjediseve dhe të sipërfaqes 12150 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr.109, me emërtim “Riparim artillerie”, sh.a. Brar, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur për nevoja urbanistike, ndërtimin e rrugës publike “Ura e Brarit-Hyrje tunel Qafë Murrizë”.

2. Mjediset dhe sipërfaqja 2716 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr.98, me emërtim “Reparti ushtarak nr.5011” në Brar, Tiranë, si dhe mjediset dhe sipërfaqja 12 150 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr.109, me emërtim “Riparim artillerie” sh.a. Brar, Tiranë, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, para fillimit të punimeve, të ndërtojnë portën hyrëse, kullat dhe murin rrethues në kufijtë e rinj të pronës, të kryejnë spostimin e rrjeteve inxhinierike që preken gjatë punimeve, si dhe të rehabilitojnë infrastrukturën e sipërfaqeve të pronave që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha